



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2023

Lënda: Kthim përgjigje

Duke shprehur konsideratën për Ju dhe median në të cilën ushtroni profesionin, në përgjigje të kërkesës tuaj, ardhur nëpërmjet postës elektronike, regjistruar me numër rendor 4, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 1389 Prot., datë 17.02.2023, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka ngarkuar Këshillin e Lartë Gjyqësor për të siguruar pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë¹. Ndër funksionet e Këshillit janë edhe emërimi, vlerësimi, ngritja në detyrë dhe transferimi i gjyqtarëve të të gjitha niveleve.²

Për sa më sipër, në lidhje me procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga viti 2022 deri më 17 shkurt 2023 rezultojnë të jenë miratuar 6 akte administrative individuale për miratim propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, më konkretisht:

1. Vendimi nr. 133, datë 06.04.2022 “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit {...}”;
2. Vendimi nr. 57 datë 10.02.2022 “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidates {...}”;
3. Vendimi nr. 80, datë 02.03.2022 “Për propozim për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatit {...}”;
4. Vendimi nr. 196, datë 27.05.2022 “Për propozim për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatit {...}”;
5. Vendimi nr. 207, datë 09.06.2022 “Për propozim për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidates {...}”;
6. Vendimi nr. 208 datë 09.06.2022 “Për propozim për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatit {...}”.

¹ Neni 147 i Kushtetutës: “1. Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.”.

² Neni 136/a dhe nenin 147/a pika 1, shkronja “a”, i Kushtetutës.

Në lidhje me procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga viti 2022 deri më 17 shkurt 2023 rezultojnë se janë miratuar 3 akte administrative individuale, më konkretisht:

1. Vendimi nr. 153, datë 20.04.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të {...}”;
2. Vendimi nr. 443, datë 01.11.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarës së Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të {...}”;
3. Vendimi nr. 445, datë 01.11.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të {...}”.

Ndërsa në lidhje me procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga viti 2022 deri më 17 shkurt 2023 rezultojnë se është miratuar 1 akt administrativ individual më konkretisht:

1. Vendimi nr. 434, datë 21.10.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të {...}”.

Lidhur me procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit nga viti 2022 deri më 17 shkurt 2023 rezultojnë se janë miratuar 8 akte administrative individuale nga të cilat 7 (shtatë) akte janë për ngritje në detyrë në Gjykatat e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe 1 (një) akt për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, më konkretisht:

1. Vendim nr. 154 datë 20.04.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë {...}”;
2. Vendim nr. 165 datë 05.05.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë të {...}”;
3. Vendim nr. 166 datë 05.05.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë të {...}”;
4. Vendim nr.167 datë 05.05.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë të {...}”;
5. Vendim nr.168 datë 05.05.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit të {...}”;
6. Vendim nr.169 datë 05.05.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë të {...}”;
7. Vendim nr.187 datë 17.05.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Durrës të {...}”;
8. Vendim nr.414 datë 10.10.2022 “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Korçë {...}”.

Lidhur me gjyqtarët e transferuar nga viti 2022 deri më 17 shkurt 2023 rezultojnë se janë miratuar 13 akte administrative individuale, prej të cilave 4 akte për transferimin e

gjqtarëve, 9 akte administrative individuale për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve në gjykata të ndryshme, më konkretisht:

1. Vendimi nr. 16, datë 17.01.2022 “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtarit {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë;
2. Vendimi nr. 202, datë 31.05.2022 “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë”;
3. Vendimi nr. 217, datë 16.06.2022 “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”;
4. Vendimi nr. 230, datë 20.06.2022 “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”;
5. Vendimi nr. 248, datë 06.07.2022 “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës”;
6. Vendimi nr. 389, datë 19.09.2022 “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”;
7. Vendimi nr. 390, datë 19.09.2022 “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë” ;
8. Vendimi nr. 400, datë 23.09.2022 “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë” ;
9. Vendimi nr. 437, datë 25.10.2022 “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë”;
10. Vendimi nr. 38, datë 23.01.2023 “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë”;
11. Vendimi nr. 57, datë 31.01.2023 “Për transferimin e gjyqtarës {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale” (bashkëlidhur relacionin me nr. 618 prot., datë 31.01.2023);
12. Vendimi nr. 58, datë 31.01.2023 “Për transferimin e gjyqtarës {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale”;
13. Vendimi nr. 59, datë 31.01.2023 “Për transferimin e gjyqtarës {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale”.

Bashkëlidhur lutemi gjeni vendimet e sipërcituara (gjithsej 251 fletë).

Ju faleminderit për mirëkuptimin!